PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB) PËR VITIN 2025

HYRJE

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) funksionon duke u bazuar në udhëzimin administrative Nr. 027/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe vendimit për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi nga Kuvendi Komunal Deçan me Nr. 01.Nr.II-3 të themeluar me 30.12.2021.

Roli i KKSB-së, është organ këshillues - konsultues për çështje të sigurisë, me përfaqësim të gjerë të të gjitha bashkësive të Komunës, si dhe përfaqësues të Shoqërisë civile, duke marrë parasysh edhe kriteret e përfaqësimit gjinor, i cili në bashkëpunim me policinë shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë në bashkësi në të mirë të të gjithë qytetarëve të Komunës. KKSB-ja ka si synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive që lidhen me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e Komunës se Deçanit.

Qëllimi i KKSB-së, është kryesisht i përqendruar në aktivitete për çështje të sigurisë, në bashkëpunim me policinë, qytetarët, institucionet arsimore dhe institucionet tjera të sigurisë, bashkësitë fetare dhe përfaqësuesit e Shoqërisë civile për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet që lidhen me problemet e sigurisë në bashkësi, me synim të zgjidhjes konkrete të këtyre problemeve.

Plani vjetor i punës së KKSB-se për vitin 2025 përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtaret e KKSB-së me qëllim të realizimit të detyrave të parapara sipas Udhëzimit Administrativ. KKSB-ja nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e përcaktuara

në këtë plan por do të jetë aktiv edhe në jetën e përditshme të qytetarëve, do të identifikoj dhe trajtoj problemet e përgjithshme të qytetarëve.

Objektivat KKSB-së :

- Mbajtja e të gjitha takimeve të rregullta për vitin 2025;
- Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e sigurisë;
- Monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së sigurisë në Komunën e Deçanit;
- Identifikimi i dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike;
- Parandalimi i veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi;
- Ndërtimi i besimit dhe bashkëpunimit në mes Komunës së Deçanit. Policisë së Kosovës, institucioneve tjera të sigurisë dhe qytetarëve në nivelin sa më të lartë që është e mundshme me qëllim të rritjes së sigurisë në bashkësi;
- Rritja e sigurisë në shkolla në të gjitha nivelet;
- Të gjitha diskutimet, vërejtjet , sugjerimet dhe kërkesat e parashtruara nga pjesëmarrësit e KKSB-së, të zgjidhen në afatin sa më të shpejtë që është e mundur.

Nr.	Muaji	Agjenda	Folësit/pjesëmarrësit	Parashtruesit e kërkesës	Aprovoi:	Informon	Vërejtje
1.	MARS	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Situata në Komunë, me ndriçim, parkingje, mbeturina dhe pastrim të rrugëve, trotuareve dhe hapësirave tjera nga dëbora; 4. Siguria në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme; 5. Situata me qentë endacak në Komunën e Deçanit 6. Të ndryshme	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtoria e Arsimit Drejtoria e MSHSHP	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	
2.	PRILL	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Situata me zjarre pranverore, fushore dhe malore. 4. Trotuaret, lirimi i tyre dhe shenjat sinjalizuese 5. Të ndryshme	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtoria MSHSHP	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	

3.	QERSHOR	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Plani Operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave 4. Të ndryshme	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtoria MSHSHP	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	
4.	GUSHT	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Fillimi i vitit të ri shkollor, gjendja e sigurisë në shkolla 4. Të ndryshme	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtoria e Arsimit	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	
5.	TETOR	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës;	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	

		3. Diskutim rreth aktivitetit për sigurinë e personave me aftësi të kufizuara-pengesat, ndalesat, shkallët, qasja në institucione dhe biznese private. 4. Plani operativ për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit. 5. Të ndryshme	Drejtoria MSHSHP	anëtarët e KKSB-së			
6.	NËNTOR	1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Marrja e masave parandaluese për mënyrën e parandalimit të përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit 4. Aktivitet – Dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuar. 5. Të ndryshme	Kryetari i Komunës dhe koordinatori Komandanti i stacionit policor të Deçanit Drejtoria MSHSHP	Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	

01.Nr.I-3
Deçan,dt.27.02.2025

K.K Deçan AS 5963
01 07.03.25

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ